



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 238/5 Prot

Tiranë, më 15.06.2022

V E N D I M

Nr.86, datë 15.06.2022

Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr. 451 prot, datë 08.03.2022 të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës Tiranë, për ushtrimin e përgjegjësisë për drejtimin administrativ të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Kurbin, prej nëpunësit civil ***.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me njoftim mbi ushtrimin e përgjegjësisë për drejtimin e “Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Kurbin”.

VËREJ SE:

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së një kërkesë, të regjistruar me nr. 238 prot, datë 25.03.2022, paraqitur nga nëpunësi ***** , konstatohet se ky nëpunës, me detyrë “Drejtor i Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë”, pretendon për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil dhe moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të transferimit të përkohshëm për interes të institucionit, të këtij punonjësit në fjalë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ të çështjes, ka rezultuar e vërtetuar se nëpunësi ***** , është emëruar rregullisht, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, në pozicionin “Drejtor i Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë”, me aktin nr. 633/1 datë 07.11.2013, të Ministrit të Drejtësisë.

Ai, ka vazhduar të punojë në këtë pozicion pune deri në momentin kur, Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse, nëpërmjet aktit nr. 451 prot, datë 08.03.2022 “Njoftim mbi ushtrimin e përgjegjësisë për drejtimin administrativ të degës territoriale të shërbimit të provës Kurbin”, ka njoftuar nëpunësin në fjalë se, për nevoja të institucionit, është ngarkuar me drejtimin administrativ të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës, Kurbin.

Shkresa e mësipërme për kalim detyrash, sqarohet se është nxjerrë me inisiativën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, në përputhje me detyrat e tij funksionale, bazuar në gërmën a) c) dhe f) të pikës 1 të nenit 8, të ligjit nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit të Provës”, ku parashikohet se Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e veprimtarisë së shërbimit të provës.

Nevoja për kryerjen e kësaj lëvizje, është diktuar nga fakti që Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Kurbin, ka qënë pa drejtues që nga data 15.12.2020, dhe në disa raste, mungesa e drejtuesit ka sjellë vështirësi në mbarëvajtjen e punës në këtë degë territoriale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Ky ngarkim për ushtrimin e përgjegjësisë të nëpunësit në fjalë, është bazuar në ligjin nr.90/2012 datë 27.09.2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore”, si dhe ligjin nr. 78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës” për shkak të nevojës së institucionit dhe në mënyrë të përkohshme, me qëllim mbarëvajtjen e punës së Degës Territoriale Kurbin.

Në përmbajtjen e shkresës nr. 648/1 prot, datë 14.04.2022, përcaktohet se ankuesi, në pozicionin ku është transferuar është ngarkuar me të njëjtat detyra të pozicionit që ka mbuluar si Drejtor i Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë, **dhe do të trajtohet me të njëjtën kategori page, pra nuk ka pasur ndryshim as në kategori pozicioni dhe as në kategori page.**

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, në përgjigjen e saj informon Komisionerin gjithashtu, se me marrjen e njoftimit për transferimin e tij, si me shkresë zyrtare dhe me e-mail, nëpunësi ***** , pavarësisht pretendimeve të mundshme të tij, e ka zbatuar pa kushte urdhërin.

Nisur nga mënyra si është vepruar në rastin e këtij veprimi administrativ, arrihet në përfundimin se është lejuar shkelje e dispozitës së pikës 7, të nenit 48, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe e pikës 5, të Kreut I, të Vendimit nr. 125 dt. 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Sipas dispozitës së sipërpërmendur, transferimi i përkohshëm që kryhet në interes të institucionit (deri në 6 muaj, me/ose pa ndërprerje, gjatë dy viteve), miratohet nga njësia përgjegjëse (në këtë rast, si e tillë duhej të paraqitej njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës) e cila shqyrton plotësimin e kushteve ligjore, e pasi bindet për mbështetjen në ligj të veprimit administrativ, nxjerr aktin përkatës dhe njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse kujdeset për ruajtjen e nivelit të kategorisë si dhe bën verifikimin e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozicionit të punës ku ai kërkohet të transferohet, si dhe në plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, siç është gjendja shëndetësore, distanca e vendit të punës nga vendi i banimit, etj.

Në rastin konkret, nevoja e këtij transferimi e evidentuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, në zbatim të detyrave për mbarëvajtjen dhe plotësimin e objektivave të institucionit, duhej të shërbente si shkak për të vënë në lëvizje njësinë përgjegjëse, të kryente detyrën e saj dhe është veprim në kundërshtim me ligjin marrja e vendimit për transferimin e përkohshëm, direkt nga drejtuesi i institucionit dhe mbi këtë bazë njësia përgjegjëse të bënte vetëm njoftimin e aktit të marrë.

Nga pikëpamja e përmbajtjes së këtij procesi administrativ, janë bërë përpjekje për të mbajtur parasysh kërkesat e pikave 1 dhe 5, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si respektimi i kategorisë dhe i pagesës, por mosrespektimi i pikës 5, të Kreut I, të vendimit nr. 125 dt. 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë” si më sipër, është një shkelje procedurale e cila e ka vënë nëpunësin në pamundësi të mbrohej e të parashtronte pretendimet e tij të mundshme, në lidhje me distancën e vendit të punës nga vendbanimi, gjendja shëndetësore, etj, të cilat mund të përbënin shkaqe për refuzimin e transferimit të përkohshëm sipas pikës 3, të nenit 48, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Nisur nga rregullat e përcaktuara në dispozitat e mësipërme, në aktin nr. 451 prot, datë 08.03.2022, të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe në aktin e Drejtorit të Përgjithshëm të Provës, gjenden elementë kundërligjshmërie që lidhen me tejkalimin e kompetencës, konstatim i cili bazohet në pikën a) të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

Një aspekt tjetër i kundërligjshmërisë është mosrespektimi i formës së duhur të kësaj lëvizje për nevoja pune, duke mos e trajtuar si transferim i përkohshëm që rregullohet nga neni 48, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, gjë e cila ka ndikuar edhe në ligjshmërinë dhe përmbajtjen e këtij veprimi administrativ.

Gjithashtu, edhe mospërcaktimi në akt, në mënyrë të shprehur i afatit të transferimit, i cili mund të jetë deri në 6 muaj brenda dy viteve, ose edhe më pak, në përputhje me nevojat e paraqitura, siç parashikohet në pikën 2/a, të Vendimit nr. 125, dt. 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil”, është aspekt i kundërligjshmërisë së aktit.

Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, bazuar në pikat 1 dhe 3, të nenit 113, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, organi publik që e ka nxjerrë aktin nr.451 prot, datë 08.03.2022, pra Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës Tiranë, me një akt të ri me shkrim, duhet të shfuqizojë aktin nr. 451 prot, dt. 08.03.2022 “Njoftim mbi ushtrimin e përgjegjësisë për drejtimin administrativ të Degës Territoriale të Shërbimit të Provës, Kurbin”, dhe ta riformulojë shprehjen e vullnetit të saj, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit civil *****, mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm, duke përcaktuar në mënyrë të shprehur kohën e transferimit dhe në zbatim të pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, datën e kthimit të nëpunësit civil në pozicionin e mëparshëm, ku ai ka emërimin e përhershëm.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90/2, 113 e 114, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

- 1- Të kërkoj nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, që të anulojë aktin nr. 451 prot, datë 08.03.2022 “Njoftim mbi ushtrimin e përgjegjësisë për drejtimin administrativ të degës territoriale të shërbimit të provës Kurbin” dhe pas kësaj Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse (e cila në këtë rast paraqitet si njësi përgjegjëse) mbi bazën e

kërkesës së Drejtorit të Përgjithshëm, pasi të vlerësojë situatën nëse ekzistojnë kushtet ligjore, të vijojë procedurën për realizimin e transferimit të përkohshëm në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil, për plotësimin e pozicionit “*Drejtues i Njesisë Territoriale të Shërbimit të Provës Kurbin*”, për një afat që do të përcaktohet në akt, por që nuk mund të jetë më shumë se gjashtë muaj, gjatë dy vjetëve.

- 2- Në akt të përcaktohet në mënyrë të shprehur se në përfundim të afatit maksimal të transferimit të përkohshëm, nëpunësi që do ngarkohet me detyrimin në fjalë, do të kthehet në pozicionin e tij të punës ku ka emërimin e përhershëm.
- 3- Të njoftohet për këtë vendim Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha